

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rustem Begolli, me zyrtaren ligjore Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurve H.B., J.B. dhe F.B., që të gjithë nga P., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1644/2017, të dt:12.06.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP.II.nr.1644/2017, të dt:12.06.2018, më **23.07.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1644/2017, e dt:12.06.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit:

H.B.: nga i ati Z., e ëma H.1, e gjinisë D., i lindur me datë ..., në fshatin Ll., Komuna P., ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., me numër të tel. ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J.B.: nga i ati H.2, e ëma A., e gjinisë M., i lindur me datë ..., në fshatin Ll., Komuna P.1, ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, me numër personal ..., me numër të tel. ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

F.B.: nga i ati H.2, e ëma A., e gjinisë M., i lindur me datë ..., në fshatin Ll., Komuna P.1, ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., me numër të tel. ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

S e p s e: Me datë 08.03.2017, rreth orës 14:00, në rrugën "A.K.", afër ambasadës së Zvicrres në Prishtinë, të pandehurit H.B., J.B. dhe F.B., pas një mosmarrëveshje, aty për aty, me të dëmtuarit M.Z. dhe S.Z., në bashkëkryerje me dashje që t'iu shkaktojnë lëndime trupore i kanë sulmuar fizikisht të dëmtuarit e lartcekur, në atë mëyrë që derisa të dëmtuarit kanë parkuar veturën në trotuar para lokalit e të pandehurve të lartcekur, dhe kur pas katër – pesë minutave janë kthyer dhe kanë hyrë në veturë, në ato momente i pandehuri F.B. i ka thënë pse je parku këtu duhet me pagu, ndërsa i dëmtuari thotë nuk mund të paguaj për trotuar, ja po i thërras policinë dhe në atë moment i pandehuri ja ka hapur derën e veturës, dhe e ka kapur për jakne dhe e ka nxjerr jashtë, ka filluar ta sulmojë, fillimisht me një mjet të fortë në vetullën e djathtë dhe së bashku me të pandehurin H.B. dhe J.B., e kanë sulmuar pa u ndalur me shkelma e grushta, dhe kur ka dalë nga vetura edhe i dëmtuari F.Z., e kanë goditur me një mjet të fortë mbrapa kokës, me ç'rast të njejtëve i'u ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin;-

Me këtë secili veç e veç kanë kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të H.B., J.B. dhe F.B. i'u shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **H.B.** dënohet me gjobë në shumë prej **400.00 € (katër qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri: **J.B.** dënohet me gjobë në shumë prej **400.00 € (katër qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri: **F.B.** dënohet me gjobë në shumë prej **400.00 € (katër qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohen të pandehurit që secili (**veç e veç**), t'i paguajnë shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, si dhe për ekspertizen mjeko – ligjore në mënyrë (**solidare**) në shumë prej **50€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarat: M.Z. dhe S.Z., që të dy me vendbanim në fshatin L., Komuna P.2, për realizimin e kërkesës pasuror juridike, udhëzohen në kontest të regullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP.II.nr.1644/2017, të dt:12.06.2018, ka akuzuar, H.B., J.B. dhe F.B. se kanë kryer veprën penale – Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se të pandehurit kanë kryer veprën penale, për të cilën akuzohen.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-AB-0806 të datës 16.03.2017, akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes nga Dr. V.H. i datës 17.08.2017, deklaratat e të dëmtuarve e dhënë në procedurën paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se të pandehurit H.B., J.B. dhe F.B., janë penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjteve i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.2673/2018 të dt. 23.07.2018

Zyrtare ligjore,
Sanije Troshupa

G j y q t a r i
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE: Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.